



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Priljavu Received/Deliverty	15. 03 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSTK	1383/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.91/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.91/2022 të datës 03.02.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted] Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.91/2022 e datës 03.02.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. **Anulohet** Vendimi me numër protokollit 015/22 i datës 24.01.2022, i Udhëheqësit të Njesisë Juridike dhe Punë të Përgjithshme në Shërbimin Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankueses si në pikën një të dispozitivit.
- III. **Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ta largoj nga dosja personale e ankueses dhe regjistri përkatës masën disiplinore "Vërejtje", të shqiptuar sipas Vendimit me numër protokollit 015/22 të datës 24.01.2022 të Udhëheqësit të Njesisë Juridike dhe Punë të Përgjithshme në Shërbimin Korrektues të Kosovës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 03.02.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 508/2022, kundër Vendimit me numër protokollit

015/2021 të datës 24.01.2022, të Udhëheqësit të Njesisë Juridike dhe Punë të Përgjithshme në Shërbimin Korrektues lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 09.03.2022 përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur çështjen në procedure.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.02.2022 me numër protokoll 508/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr:015/2022 të datës 24.01.2022 mbi shqiptimin e masës disiplinore vërejtje; Postimin e ankueses në rrjetin social facebook të datës 14.01.2022; Postimin e ankueses në rrjetin social facebook të datës 11.02.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.02.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 09.03.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës; Akt emërimit e ankueses të datës 05.03.2013 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Vlerësimin e rezultateve në punë të vitit 2021 për ankuesen i datës 24.01.2022; Vlerësimin e rezultateve në punë i vitit 2020 për ankuesen i datës 09.12.2020; Vlerësimin e rezultateve në punë i vitit 2019 për ankuesen i datës 06.12.2019; Raportin zyrtar të datës 20.01.2022 nga Ushtruesi i detyrës së Mbikëqyrësit të Zyrtarëve për punë Sociale dhe Rregulloren QRK-NR.31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë; emaili i datës 15.03.2022 nga Menaxheri i Personelit të SHKK-së me numër protokoll 1349/2022 lidhur me provat shtesë fq.1/4.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizua shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses, **sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja është e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 05.03.2013 në pozitën *Zyrtare për punë sociale*, në Qendrën Korrektuese në Dubravë në kudër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Më datë 24.01.2022 Udhëheqësi i Njesisë Juridike dhe Punë të Përgjithshme në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka nxjerrë Vendimin me numër protokoll 015/22, përmes të cilit ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", duke e gjetur fajtor edhe përgjegjëse ankuesen sepse e njëjta me datë 14.01.2022 ka postuar në statusin e saj në facebook komentet siç figuron "*Paramendo me qenë vlerësuesi me i dobët se i vlerësuar*" si dhe komentin "*Paramendo derri me mësuar Perëndeshën e dijës, ama i kërkon falje derri për fyerjen*", e këto veprime i ka bërë në kohën kur ka marrë Formularin me vlerësim për punën e kryer gjatë vitit të kaluar, dhe me këtë ka bërë shkelje disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nënparagrafi 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

E pa kënaqur me Vendimin me numër protokoll 015/22 të datës 24.01.2022 për shqiptimin e "Vërejtjes", ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Vendimi i goditur me ankesë është i kundërligjshëm ngase nuk është nxjerrë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i saj, se vërejtja e shqiptuar paraqet shkelje të rëndë ligjore në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, shkelje të Deklaratës



Universale për të Drejtat e Njeriut si dhe vendimi i atakuar është tendencioz, tutje shton se postimet e saj në facebook nuk kanë të bëjnë me Mbikëqyrësin e saj, ngase kohë pas kohe e njëjta bënë postime në profilin e saj të karakterit letrar dhe poetikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga provat e lëndës ka konstatuar se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesen është bërë me datë 21.01.2022 nga Ushtruesi i detyrës së Mbikëqyrësit të zyrtarëve për punë sociale pranë Njesisë organizative/Shërbimi për punë sociale në Qendrën Korrektuese në Dubravë, ndërsa në bazë të përshkrimit të detyrave të punës të datës 27.02.2012 ankuesja raporton tek Udhëheqësi për Punë Juridike dhe të Përgjithshme në Qendrën Korrektuese në Dubravë, kështu që mbi këtë bazë Kolegji konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesen, nuk është bërë nga Mbikëqyrësi i saj drejtpërdrejtë ashtu siç përcaktohet me nenin 43 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114, për Zyrtarët Publik si dhe me asnjë prove nuk dëshmohet se Udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankueses, ka ftuar të njëjtën paraprakisht në takim për të diskutuara rreth arritjes dhe realizimit të objektivave të punës për vitin 2021 ashtu siç kërkohet sipas nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar Vendimin e kontestuar me ankesë dhe rrjedhimisht ka gjetur se masa disiplinore "Vërejtja" e datës 24.01.2022 e shqiptuar ndaj ankueses, bazohet në postimin e ankueses në profilin e saj në facebook të datës 14.01.2022 me tekstin se: "*Paramendo me qenë vlerësuesi më i dobët se i vlerësuarit*" si dhe komentin tjetër "*Paramendo derri me mësua përëndeshën e dijes, ama i kërkon falje derrit për fyerjen*", rrjedhimisht bazuar në shkresat e lëndës rezulton se postimi i ankueses me shprehjet si me lartë është bërë me datë 14.01.2022 në orën 6:43 pra pas orarit zyrtar të punës, ndërsa vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 për ankuesen është bërë me datë 21.01.2022, pra shtatë (7) ditë para së të njëjtës ti dorëzohet vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021, andaj, mbi këto arsye Kolegji nuk ka mundur të konstatoj se ankuesja me veprimet e saj të postuara me datë 14.01.2022 në profilin e saj në facebook në mënyre indirekte ka fyer Udhëheqësin e Njesisë Juridike dhe Punë të Përgjithshme apo Ushtruesin e detyrës së Mbikëqyrësit të zyrtarëve për punë sociale siç pretendohet në raportin Zyrtar të datë 20.01.2022 të këtij të fundit, kështu që Kolegji me të drejt vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses.

Në aspekt të vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ju referua nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *1.Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, respektivisht nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke u bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga elementet që do të bënte përgjegjëse ankuesen lidhur me shkeljet disiplinore të pretenduara nga Mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejtë.*

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenet 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar



edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar si me lartë dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.91/2022

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.